

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Frosina Sylejmani, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.K. nga fshati ..., Komuna e Gllogovcit, kundër të paditurës Republika e Serbisë - Qeveria e R.S, rr. e Nemanjës nr.11, 11000 Beograd, me objekt të padisë kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 761.100 €, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Gllogovc C.nr.52/12, i datës 08.01.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.03.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses N.K. nga fshati ..., Komuna e Gllogovcit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Gllogovc C.nr.52/12, i datës 08.01.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.52/12, i datës 08.01.2016, është shpallur inkompetente dhe e ka hedhur poshtë padinë e paditëses N.K. nga fshati ..., Komuna e Gllogovcit, e paraqitur me datën 26.03.2012, kundër të paditurës Republika e Serbisë- Qeveria, me objekt të padisë kompensimin e dëmit.

Kundër këtij aktvendimi pala paditëse në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që ankesa të miratohet si e bazuar, aktvendimin i atakuar të priset, dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje apo pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të administruara në shqyrtim të drejtpërdrejt aktvendimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe e njëjta gjykatë të shpallet kompetente në çështjen juridike për kompensim të dëmit dhe të pranohet padia e paditëses N.K. si e lejuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditëses është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse me datë 26.03.2012, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Gllogovc, ka paraqitur padi, me objekt kompensimin e dëmit, kundër të paditurit, Republika e Serbisë- Qeveria e R.S, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që t'ia paguajë dëmet materiale dhe jo materiale të gjenocidit serb të cilat i ka paraqitur në padi dhe kërkesëpadi në shumën

prej 761.100 €, me kamatë ligjore dhe obligim në pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit paraprak të padisë në bazë të dispozitës së neneve 17 paragrafi 1, 18.1, 37 paragrafi 1, 38.1, 39.2 dhe nenit 392 paragrafi 1 pika a) të LPK-së, ka vendosur që Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Gllogovc, të shpallët jo kompetente për të vendosur në kontestin e paditëses N.K., kundër të paditurës Republika e Serbisë-Qeveria e Republikës së Serbisë Beograd dhe e ka hedhur poshtë padinë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Është i drejtë vlerësimi juridik i gjykatës së shkallës së parë se gjykata gjatë gjithë procedurës kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse zgjidhja e kontestit hyn ose jo në kompetencë gjyqësore, pasi që këtë detyrim për gjykatën e përcakton dispozita e nenit 18 paragrafi 1 e LPK-së, ku theksohet se: “*Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hyn ose jo në kompetencë gjyqësore*” ndërsa me dispozitën e nenit 18 paragraf 3 të LPK-së, përcaktohet se: “*Kur gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do të shpallet inkompetente, do të anulohet veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedh poshtë padinë.....*”. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka vepruar në pajtim të plotë edhe me dispozitën e nenit 18 paragrafi 3 të LPK-së, të cilës i është referuar me të drejtë.

Deri të përfundimi logjik dhe juridik se Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Gllogovc nuk ka pasur kompetencë të vendos për çështjen kontestuese ku palë e paditur është Republika e Serbisë-Qeveria e Republikës së Serbisë, sjell edhe përcaktimi i dispozitës së nenit 39 paragrafi 1, i LPK-së, e cila shprehimisht thotë: “*Për gjykimin në kontestet kundër Kosovës, njësisë vetëqeverisjes lokale, si dhe formave tjera të organizimit territorial, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e kuvendit të saj*”, ndërsa në paragrafin 2 të nenit 39 të LPK-së, përcaktohet se: “*Për gjykimin në kontestet kundër personave juridik të tjerë e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e të cilës ndodhet selia e tyre e regjistruar*”.

Në çështjen konkrete juridike është fakt notor se Qeveria e Republikës së Serbisë, selinë e ka në Beograd, nga rrjedh se në bazë të dispozitave të cituara nga neni 39 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, për të vendosur në konteste kundër Republikës së Serbisë, është e kompetencës së përgjithshme territoriale gjykata në territorin e secilës ndodhet selia e Qeverisë se Republikës së Serbisë.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me shtet të huaj, gjegjësisht me Qeverinë e Republikës së Serbisë, selia e të cilës ndodhet në Beograd, prandaj në kuptim të dispozitave të cituara dhe në bazë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare rezulton së një shtet nuk mund të paditet në shtetin tjetër, respektivisht sipas parimit të njohur ndërkombëtar *par in parem non habet iudicio*, organet e një shteti nuk mund të vendosen nën juridiksionin e organeve të një shteti tjetër, për çka paditë e kësaj natyre duhet të bëhen në vetë shtetin dhe pranë organeve të atij shteti, nga i cili kërkohet dëmshpërblimi.

Nga arsyet e cekuar Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj ne mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.797/2016, datë 29.03.2018

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka, d.v